



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE
BALLKANIKE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Leksikologji Turke

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; 20 leksione / 20 seminare
Semestri kur zhvillohet: Viti II / Semestri II
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Bachelor - Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Turk
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

- Të marrë njohuritë bazë të lëndës së leksikologjisë turke.
- Të njihet me terminologjinë e përdorur në leksikologji në gjuhën turke.
- Të mësojë njësinë leksikore të gjuhës turke.
- Të dallojë njësitë leksikore të gjuhës turke.
- Të analizojë njësitë leksikore të gjuhës turke në tekstet e përzgjedhura në orën e seminarëve.

Objektivat specifike lëndore:

- Të dallojë leksemën në gjuhën turke.
- Të mësojë strukturat e dubleteve, shprehjeve frazeologjike dhe fjalëve të urta
- Të përdorë saktë sipas konteksteve të caktuara pasurinë leksikore të gjuhës turke.
- Të arrijë të dallojë shtresën vetjake të leksikut të turqishtes.
- Të arrijë të dallojë shtresën e huazuar të leksikut,
- Të referojë detyrën e kursit duke punuar mbi një material të përzgjedhur nga gjuha turke.
- Të përdorë saktë në gjuhën turke shprehje frazeologjike dhe struktura të ngurtësuara.
- Të punojë me fjalorë të gjuhës turke për të pasuruar të shprehurit në gjuhën turke